

LIGJ
Nr.7556, datë 4.2.1992

PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenve 16 e 17 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Zgjedhjet për deputetë të Kuvendit Popullor bëhen në territorin e Republikës së Shqipërisë me votim të përgjithshëm, të drejtpërdrejtë, të lirë dhe të fshehtë.

Neni 2

Të drejtën për të votuar e kanë të gjithë shtetasit shqiptarë që ditën e zgjedhjeve mbushin moshën 18 vjeç.

Të drejtën për t'u zgjedhur deputet në Kuvendin Popullor e kanë të gjithë ata që ditën e zgjedhjeve mbushin moshën 21 vjeç, kanë shtetësinë shqiptare dhe vendbanim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Nga e drejta elektorale përjashtohen shtetasit, të cilëve u është hequr kjo e drejtë me vendim të gjykatës për shkak se kanë kryer një vepër penale, si dhe të paaftët mendërisht të cilësuar të tillë nga gjykata.

Neni 4

Çdo zgjedhës ka të drejtën vetëm të një vote.

Vota e një zgjedhësi është e barabartë me votën e çdo zgjedhësi tjetër.

Neni 5

Deputeti i Kuvendit Popullor nuk mund të jetë në të njëjtën kohë anëtar i zgjedhur apo i emëruar në organet lokale të pushtetit të administratës shtetërore, si dhe në organet e drejtësisë.

KREU II
SISTEMI I ZGJEDHJEVE

Neni 6

Kuvendi Popullor përbëhet nga jo më pak se 140 deputetë, nga të cilët 100 zgjidhen drejtpërdrejt në zona njëemërore, kurse mandatet shtesë kompensues u jepen kandidatëve që janë në listat e subjekteve në shkallë vendi, sipas proporcionit të votave të fituara në raundin e parë.

Neni 7

Quhet i zgjedhur deputet në Kuvendin Popullor në zonën njëemërore, kandidati që fiton më tepër se gjysmën e gjithë votave të vlefshme në atë zonë.

Neni 8

Në qoftë se në raundin e parë të zgjedhjeve asnjëri nga kandidatët nuk fiton më shumë se 50 për qind të votave të vlefshme, atëherë pas një jave bëhet një raund i dytë zgjedhjesh në zonën përkatëse.

Kandidatë për deputetë në raundin e dytë të zgjedhjeve paraqiten dy kandidatët që kanë marrë numrin më të madh të votave në raundin e parë.

Në qoftë se një subjekt elektoral e tërheq kandidatin e vet nga raundi i dytë i zgjedhjeve, si kandidat zëvendësues paraqitet ai që ka përqindjen më të madhe të votave ndër kandidatët e tjerë që kanë marrë pjesë në raundin e parë të zgjedhjeve.

Shpallja e kandidatëve për raundin e dytë bëhet nga komisioni i zgjedhjeve të zonës.

Neni 9

Në raundin e dytë të zgjedhjeve quhet i zgjedhur deputet në Kuvendin Popullor kandidati që ka fituar numrin më të madh të votave. Në rast se votat ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet kandidatëve, atëherë për zgjedhjen e deputetit përdoret shorti.

Neni 10

Subjektet që kanë vënë kandidatë të përbashkët në zonën elektorale, duhet të paktën 8 ditë para zgjedhjeve të dërgojnë në komisionin e zgjedhjeve të zonës raportin me të cilin duhen ndarë votat e fituara bashkërisht, që do të mblidhen në shkallë vendi.

Neni 11

Mandatet shtesë shpërndahen si më poshtë:

a) Llogaritet përqindja e përgjithshme e votave që ka fituar në raundin e parë të zgjedhjeve në zonat njëemërore çdo subjekt nëpërmjet kandidatëve të tij në shkallë vendi.

b) Çdo subjekt merr një numër vendesh nga lista shumëemërore e tij, në mënyrë që numri i përgjithshëm i vendeve në Kuvendin Popullor të jetë i barabartë me numrin e vendeve që i takojnë në bazë të përqindjes së fituar dhe që numri i deputetëve të jetë më i vogli i mundshëm. Kjo bëhet sipas llogaritjeve të paraqitura në shtojcën 1.

Përcaktimi i fituesve nga lista shumëemërore bëhet sipas renditjes së tyre në listë.

Nga kjo ndarje përfitojnë vetëm subjektet që kanë jo më pak se 4 për qind të votave në shkallë vendi.

KREU III SUBJEKTET ELEKTORALE

Neni 12

Çdo shtetas shqiptar që gëzon të drejtën për t'u zgjedhur sipas këtij ligji, mund të paraqitet si kandidat për deputet në Kuvendin Popullor si përfaqësues i çdo partie, i një grupi partish ose kandidat i pavarur.

Çdo kandidat nuk mund të paraqitet më tepër se në një zonë njëemërore.

Çdo kandidat në një zonë zgjedhjeje njëemërore mund të paraqitet njëkohësisht edhe si kandidat në listën e subjektit përkatës. Kandidati që fiton në një zonë zgjedhjeje është deputet i zonës dhe hiqet nga lista në shkallë vendi e subjektit të tij.

Neni 13

Kandidati për deputet në Kuvendin Popullor regjistrohet nga komisioni i zgjedhjeve të zonës jo më vonë se 20 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Për të bërë regjistrimin paraqiten këto dokumente:

a) Kërkesa me shkrim nga subjekti përkatës elektoral, në të cilën kërkohet regjistrimi i kandidatit të paraqitur për deputet; kërkesa duhet të përmbajë emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen e kandidatit dhe vendbanimin (2 kopje).

b) Deklarata e kandidatit që pranon vënien e kandidaturës së tij në atë zonë zgjedhjeje (2 kopje).

c) Një listë e nënshkruar nga jo më pak se 400 zgjedhës të zonës përkatëse, të cilët përkrahin paraqitjen e kandidatit në atë zonë.

Neni 14

Lista me nënshkrimet e zgjedhësve duhet të përmbajë emërtimin, simbolin ose siglën e subjektit elektoral që do ta paraqesë kandidatin ose shënimin nëse kandidati është i pavarur.

Kjo listë duhet të përmbajë, gjithashtu, emrin, atësinë, mbiemrin, adresën, numrin e letërnjoftimit dhe nënshkrimin e zgjedhësit, i cili duhet të banojë në zonën ku kandidati paraqitet dhe vërtetohet në komisionin e zgjedhjeve të zonës.

Një zgjedhës, nuk ka të drejtë të nënshkruajë në më shumë se një listë. Listat depozitohen në Komisioni Qendror të Zgjedhjeve dhe mund të kontrollohen me autorizim të rregullt të tij.

Kur komisioni i zgjedhjeve i zonës vëren parregullsi në kërkesën dhe dokumentet për regjistrimin e kandidatëve, njofton subjektet elektorale për ndreqjen e tyre brenda dy ditëve nga konstatimi. Në rast të kundërt, komisioni i zgjedhjeve, i zonës merr vendimin përkatës.

Neni 15

Kanë të drejtë të paraqesin lista deri në 100 kandidatë për mandatet shtesë kompensues sipas proporcionit, subjektet elektorale që kanë paraqitur kandidatë në jo më pak se 33 zona zgjedhjeje dhe në 9 rrethe të vendit.

Lista me nënshkrimin dhe vulën përkatëse të subjektit elektoral paraqitet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, jo më vonë se 20 ditë para ditës së votimit.

Neni 16

Komisionet e zgjedhjeve të zonave elektorale, kur janë plotësuar kushtet e këtij ligji, detyrohen të regjistrojnë të gjithë kandidatët për deputetë në Kuvendin Popullor dhe të bëjnë shpalljen e tyre jo më vonë se 15 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, duke shënuar edhe emrin e subjektit që e ka paraqitur. Ato u dërgojnë një kopje të vërtetimit të gjithë kandidatëve të subjekteve elektorale.

Neni 17

Për çdo kandidat për deputet, komisioni i zgjedhjeve të zonës mban një procesverbal regjistrimi sipas formës së caktuar.

Një kopje e këtij procesverbali i dërgohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, bashkë me deklaratën e kandidatit që pranon vënien e kandidaturës së tij në atë zonë.

Neni 18

Kur një kandidat për deputet në Kuvendin Popullor hiqet nga subjekti propozues, tërheq kandidaturën e vet ose vdes pasi është regjistruar nga komisioni i zgjedhjeve të zonës, subjekti përkatës mund të regjistrojë një kandidat tjetër, por jo më vonë se 7 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Në qoftë se kjo ndodh gjatë 7 ditëve para zgjedhjeve, atëherë subjekti elektoral paraqet në vend të tij një kandidat tjetër nga lista partiake e kandidatëve.

Neni 19

Në rast se:

- a) anëtarët e Këshillit të Ministrave,
- b) drejtusit e komiteteve ekzekutive të rretheve, rajoneve e qyteteve (kryetari, zëvendëskryetari dhe sekretari) në zonat ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre, paraqesin kandidaturën për deputetë, lirohen nga detyra 20 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Nuk kanë të drejtë të paraqesin kandidaturë për deputet:

- a) drejtuesit e organeve të ruajtjes së rendit publik e të shërbimit informativ kombëtar në rrethe, rajone e qytete,
- b) ushtarakët e shërbimit të detyrueshëm dhe aktiv, në zonat ku ndodhen të dislokuara njësitë apo repartet e tyre ushtarake.

KREU IV LISTAT E ZGJEDHËSVE

Neni 20

Zgjedhjet për deputetë të Kuvendit Popullor bëhen në bazë të listave të zgjedhësve.

Në listat e zgjedhësve regjistrohen të gjithë shtetasit që gëzojnë të drejtën e votës. Organi kompetent (sipas këtij ligji) për hartimin e listave të zgjedhësve, kur regjistrohen zgjedhës me banim të përkohshëm në territorin e tij, është i detyruar të njoftojë organin përkatës të vendbanimit të përhershëm të zgjedhësve, me qëllim që këta të mos regjistrohen në dy vendbanime.

Çdo shtetas regjistrohet vetëm në një listë zgjedhjeje.

Neni 21

Listat e zgjedhësve hartohen për çdo qendër votimi.

Në listat e zgjedhësve shënohen: emri, atësia, mbiemri i votuesit, datëlindja e tij dhe numri i regjistrimit.

Në qytete, lagje qytetesh dhe fshatra, listat e zgjedhësve hartohen nga komitetet ekzekutive pluraliste të përkohshme.

Listat e zgjedhësve nënshkruhen nga kryetari dhe sekretari i komitetit ekzekutiv pluralist të përkohshëm.

Listat e zgjedhësve shpallen nga organi që i ka hartuar jo më vonë se 25 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

Neni 22

Për zgjedhësit që shërbejnë dhe banojnë në njësitë e repartet ushtarake, listat e zgjedhësve hartohen dhe shpallen jo më vonë se 25 ditë para ditës së zgjedhjeve nga komitetet ekzekutive pluraliste të përkohshme më të afërta, në bashkëpunim më komandat e njësive dhe të reparteve ushtarake.

Të gjithë ushtarakët e tjerë regjistrohen në listat e zgjedhësve të vendbanimit të tyre të hartuara nga komitetet ekzekutive pluraliste të përkohshme.

Neni 23

Shtetasit shqiptar me banim të përhershëm jashtë shtetit, të cilët do të ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë deri ditën e zgjedhjeve, regjistrohen në listat e zgjedhësve të ish-vendbanimit të tyre kur e kërkojnë këtë. Pjesëmarrja në votim e këtyre personave shënohet në pasaportën ndërkombëtare që mbajnë.

Neni 24

Në spitalet, sanatoriumet dhe institucionet e tjera shëndetësore e riaftësuese, në kampet e riedukimit dhe në vendet e paraburgimit listat e zgjedhësve përgatiten nga drejtuesit e institucioneve, të kampeve të riedukimit ose të vendeve të paraburgimit mbi bazën e dokumentit identifikues të zgjedhësve.

Drejtuesit e këtyre detyrohen të njoftojnë organin kompetent të pushtetit lokal të vendbanimit të këtyre zgjedhësve, për të bërë ndryshimet në listat e zgjedhësve ku ata fillimisht janë regjistruar.

Neni 25

Kur një zgjedhës caktohet anëtar komisioni zgjedhjesh ose vëzhgues në një zonë apo qendër votimi dhe për këtë shkak do të largohet nga vendbanimi pas shpalljes së listës së zgjedhësve para ditës së zgjedhjeve, me kërkesën me shkrim të subjektit elektoral, organi kompetent i lëshon një çertifikatë për të votuar në vendin ku do të shkojë dhe në listën e zgjedhjeve shënon fjalën "larguar". Ky zgjedhës regjistrohet në listën shitesë të zgjedhësve të qendrës së votimit të vendit, ku do të shkojë, me të paraqitur çertifikatën e të drejtës së votës, bashkë me letërnjoftimin ose ndonjë dokument tjetër që e zëvendëson atë.

Neni 26

Organi që ka shpallur listat e zgjedhësve, me vendim mund të bëjë ndryshim në këto lista, por jo më vonë se 24 orë para ditës së zgjedhjeve, kur një shtetas ka vdekur, është regjistruar dy herë, nuk figuron i regjistruar, nuk gëzon të drejtën e zgjedhjes ose ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 27

Çdo votues ka të drejtë të bëjë një kërkesë me shkrim për ndreqjen e gabimeve e të mangësive në listat e zgjedhësve si mungesë regjistrimi, heqje nga lista, ndryshime në emër, atësi ose mbiemër, regjistrim i personave që kanë humbur të drejtën e zgjedhjes etj. Kërkesa bëhet në organin që ka shpallur listat, i cili detyrohet ta shqyrtojë atë brenda dy ditëve dhe të japë vendim të argumentuar.

Kundër vendimit mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit, e cila brenda 3 ditëve, në prani të ankuesit e të përfaqësuesit të organit që ka shpallur listat, shqyrton ankimin në seancë gjyqësore me dyer të hapura dhe merr vendimin përkatës. Vendimi gjyqësor shpallet menjëherë dhe është i formës së prerë.

Çdo ndryshim që bëhet në listat e zgjedhësve, shpallet menjëherë.

Neni 28

Listat e zgjedhësve vihen në dispozicion të subjekteve elektorale nga organet që kanë shpallur listat, mbi bazën e kërkesës dhe kundrejt pagesës.

KREU V ZONAT E ZGJEDHJEVE DHE QENDRAT E VOTIMIT

Neni 29

Për zgjedhjen e deputetëve të Kuvendit Popullor, krijohen 100 zona, me numër afërsisht të barabartë zgjedhësish. Zonat duhet të jenë kompakte, me vazhdimësi gjeografike dhe në krijimin e tyre duhet të respektohet ndarja asministrative- tokësore.

Numri i zonave sipas retheve caktohet me këtë ligj sipas listës së bashkëngjitur (shtojca 2), ndërsa kufijtë e zonave të zgjedhjeve si dhe renditja caktohen nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Këshillit të Ministrave jo më vonë se 35 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

Neni 30

Votimi dhe numërimi i votave bëhet në qendrat e votimit, të cilat krijohen në territorin e çdo qyteti, lagjeje qyteti dhe fshati.

Neni 31

Në fshatra, për çdo 100 deri në 800 zgjedhës ngrihet një qendër votimi.

Në qytete e lagje qytetesh, për çdo 800 zgjedhës ngrihet një qendër votimi.

Për qytetet e lagjet e qyteteve që kanë më shumë se 800 zgjedhës ngrihet qendër votimi e veçantë. Për mbetjet më të mëdha se 400 zgjedhës krijohet qendër votimi e veçantë ndërsa mbetjet më të vogla i bashkohen qendrës së votimit më të afërt.

Kur një qendër pune është larg nga qendra më e afërt e votimit më shumë se 3 km, aty ngrihet qendër votimi e veçantë, në qoftë se ka, së paku, 50 zgjedhës.

Neni 32

Qendrat e votimit caktohen jo më vonë se 20 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Në qytete, në lagje qytetesh dhe fshatra qendrat e votimit krijohen me vendim të komiteteve ekzekutive pluraliste të përkohshme.

Neni 33

Në spitale, senatoriume, shtëpi lindje shtëpi pushimi dhe institucione të tjera si këto, në kampe riedukimi e vende paraburgimi ngrihen qendra votimi, në qoftë se kanë më shumë se 15 zgjedhës.

Në institucionet shëndetësore që kanë shumë pavione, mund të ngrihet një qendër votimi e veçantë për çdo pavion, në qoftë se secili prej tyre ka më shumë se 15 zgjedhës.

KREU VI KOMISIONET E ZGJEDHJEVE

Neni 34

Për drejtimin e zgjedhjeve të Kuvendit Popullor ngrihen këto komisione të zgjedhjeve:

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
- b) komisionet e zgjedhjeve të zonave;
- c) komisionet e qendrave të votimit.

Në komisionet e zgjedhjeve marrin pjesë përfaqësues të subjekteve elektorale, si dhe persona pa parti.

Komisionet e zgjedhjeve janë organizma të pavarur, që nëveprimtarinë e tyre i nënshtrohen vetëm ligjit.

Zëvendëskryetari ose sekretari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe zëvendëskryetarët ose sekretarët e komisioneve të zgjedhjeve të zonave, duhet të jenë juristë.

Vendimet e këtyre komisioneve merren me shumicë votash.

Neni 35

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe 14 anëtarë.

Përbërja e Komisionit Qendror vendoset nga Presidenti i Republikës me propozimin e partive politike, jo më vonë se 35 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

Partitë politike që nuk kanë anëtarë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kanë të drejtë të dërgojnë vëzhgues.

Neni 36

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kryen kryesisht këto detyra:

a) Kujdeset për zbatimin e përpiktë dhe të njëlojtë të këtij ligji, gjatë zhvillimit të zgjedhjeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

b) Ushtron drejtimin metodologjik dhe kontrollon veprimtarinë e komisioneve të zgjedhjeve të zonave.

c) Shqyrton ankimet kundër akteve dhe veprimeve të paligjshme e të parregullta të komisioneve të zgjedhjeve të zonave.

ç) Regjistron dhe njofton pjesëmarrjen në zgjedhje të partive, grupimeve të tyre dhe kandidatëve të pavarur, si dhe simbolet dhe siglat e tyre. Asnjë parti ose grupim partiak nuk ka të drejtë, pas regjistrimit, të përdorë simbolet e një partie ose grupimi tjetër.

d) Ushtron kontroll për regjistrimin e listave të kandidatëve në zona për deputetë në Kuvendin Popullor.

dh) Vendosi rregulla për pjesëmarrjen në zgjedhje të vëzhguesve të brendshëm dhe të huaj dhe u siguron atyre dokumentin identifikues.

e) Kontrollon kur është rasti, listat e zgjedhësve, pas përfundimit të zgjedhjeve dhe kur gjen që një shtetas ka votuar më tepër se një herë, ia parashtron çështjen organit kompetent.

ë) Njofton përfundimet e zgjedhjeve dhe regjistron deputetët e Kuvendit Popullor.

g) I lëshon deputetit të zgjedhur sipas listës partiake në shkallë vendi vërtetimin e zgjedhjes së tij.

Neni 37

Në çdo zonë zgjedhjeje ngrihet komisioni i zgjedhjeve i zonës, i përbërë nga kryetari, zëvendëskryetari, sekretari, nga një përfaqësues i subjekteve elektorale që kanë kandidatë në atë zonë, si dhe një person pa parti që caktohet nga komiteti ekzekutiv pluralist i përkohshëm i rrethit, kur numri i komisionit është çift.

Komisioni i zgjedhjeve të zonës caktohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me propozim të komiteteve ekzekutive pluraliste të përkohshme dhe pas tërheqjes së mendimit të partive politike jo më vonë se 25 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

Neni 38

Komisioni i zgjedhjeve të zonës kryen këto detyra:

a) Kujdeset për zbatimin e përpiktë dhe të njëlojtë të këtij ligji gjatë zhvillimit të zgjedhjeve në të gjithë territorin e zonës.

b) Ushtron kontroll mbi veprimtarinë e komisioneve të qendrave të votimit gjatë zhvillimit të zgjedhjeve.

c) Mbikëqyr formimin sipas ligjit të qendrave të votimit.

ç) Mbikëqyr zhvillimin e veprimtarisë përgatitore për hartimin e shpalljen e listave të zgjedhësve, si dhe lëshon certifikatat për të drejtë vote.

d) Pajis komisionet e qendrave të votimit me kuti votimi, zarfe, fletë votimi, procesverbale dhe materiale të tjera të nevojshme për zhvillimin e zgjedhjeve. Ushtron kontroll për ruajtjen, shpërndarjen dhe transportimin e këtyre materialeve.

dh) Regjistron dhe shpall kandidatët për deputetë të paraqitur sipas rregullores të këtij ligji.

e) Regjistron përfaqësuesit e kandidatëve për deputetë të partive të ndryshme, të grupimeve të partive e të kandidatëve të pavarur dhe u jep atyre vërtetimin përkatës.

ë) Numëron votat në mbështetje të procesverbaleve të qendrave të votimit dhe shpall përfundimet e zgjedhjeve në zonë.

f) Shqyrton ankimet kundër akteve dhe veprimeve të paligjshme ose të parregullta të komisioneve të qendrave të votimit.

g) I lëshon deputetit të zgjedhur vërtetimin e zgjedhjes së tij.

gj) I dorëzon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve aktet e zgjedhjeve, që përcakton ky ligj.

Neni 39

Në çdo qendër votimi ngrihet komisioni i qendrës së votimit i përbërë nga kryetari, sekretari

dhe nga një përfaqësues i subjekteve elektorale që kanë kandidatë në atë zonë.

Komisioni i qendrës së votimit miratohet, jo më vonë se 20 ditë para ditës së zgjedhjeve, nga komisioni i zgjedhjeve të zonës, me propozim të komitetit ekzekutiv pluralist të përkohshëm, pas tërheqjes së mendimit të partive politike.

Neni 40

Komisioni i qendrës së votimit kryen këto detyra:

- a) Siguron zhvillimin e lirë dhe të qetë të zgjedhjeve në qendrën e votimit, në përputhje me këtë ligj.
- b) Siguron mbajtjen e rregullit gjatë votimit.
- c) Numëron votat e hedhura për çdo kandidat për deputet.
- ç) Përgatit dhe i dorëzon komisionit të zgjedhjeve të zonës procesverbalin e votimit.
- d) Regjistron në procesverbal ankesat dhe kërkesat e zgjedhësve ose të kandidatëve, i shqyrton ato dhe merr menjëherë vendimin përkatës.
- dh) I dërgon komisionit të zgjedhjeve të zonës aktet e zgjedhjeve, që përcakton ky ligj.

Neni 41

Udhëzimet e kryetarit të komisionit të qendrës së votimit, në kohën e zgjedhjeve, janë të detyrueshme për të gjithë shtetasit që ndodhen në qendrën e votimit. Këto udhëzime mund të anulohen vetëm me vendim të komisionit të qendrës së votimit.

Neni 42

Anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve mund të lirohen nga detyra e tyre në këto komisione prej organit që ka miratuar përbërjen e komisionit, me kërkesë ose me propozim të subjekteve elektorale që përfaqësojnë.

Neni 43

Nuk mund të jenë anëtarë të komisioneve të zgjedhjeve anëtarët e komiteteve ekzekutive pluraliste të përkohshëm, ushtarakët, punonjësit e organeve të ruajtjes së rendit publik dhe të shërbimit informativ kombëtar, si dhe kandidatët për deputetë në Kuvendin Popullor.

Neni 44

Mbledhjet e komisioneve të zgjedhjeve janë të vlefshme kur në to marrin pjesë më tepër se 1/2 e anëtarëve të tyre. Vendimet në këto mbledhje merren me shumicë votash.

Mbledhjet e komisioneve të zgjedhjeve janë publike. Në to mund të marrin pjesë edhe vëzhgues, të cilët kanë të drejtë të bëjnë vërejtje. Me kërkesën e tyre vërejtjet shënohen në procesverbalin e mbledhjes së komisionit.

Neni 45

Subjektet elektorale dhe kandidatët e pavarur kanë të drejtë të paraqesin një listë me emrat e personave për të zëvendësuar përfaqësuesit e tyre, të cilët bëjnë pjesë në komisionet e zgjedhjeve të zonave dhe të qendrave të votimit. Kur këta të fundit janë të paaftë për të kryer funksionet, zëvendësimi i tyre bëhet në këtë mënyrë: a) për komisionet e qendrave të votimit me vendim të komisionit të zgjedhjeve të zonës; b) për komisionet e zgjedhjeve të zonave me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 46

Personat që marrin pjesë në Komisionin Qendror apo në komisionet e zonave të zgjedhjeve

shkëputen nga puna kundrejt pagesës që ditën e caktimit të tyre, ndërsa ata të komisioneve të qendrave të votimit kanë të drejtë të shkëputen nga puna kundrejt pagesës 3 ditë para votimit dhe 2 ditë pas votimit.

Shpërblimi i personave të mësipërm bëhet nga buxheti i shtetit, në masën e caktuar prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Masa e shpërblimit për anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve caktohet nga Presidenti i Republikës.

Neni 47

Në kuptim të Kodit Penal, quhen "persona të ngarkuar me detyrë shtetërore" të gjithë personat që bëjnë pjesë në komisionet e zgjedhjeve gjatë ushtrimit të detyrës.

Neni 48

Anëtarët e komisionit të zgjedhjeve dhe vëzhguesit, gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre, ndalohet të mbajnë shenja dalluese apo simbole të partisë ose grupimit të cilit i përkasin dhe as të kryejnë ose të marrin pjesë në veprimtari propagandistike për zgjedhjet.

KREU VII ANKIMET KUNDËR VENDIMEVE TË KOMISIONIT TË ZGJEDHJEVE

Neni 49

Vendimet e komisionit të zgjedhjeve të zonave mund të ankimohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, brenda 3 ditëve nga shpallja e tyre.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shqyrton ankimet dhe brenda 3 ditëve merr vendim përkatës.

Neni 50

Kundër vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mund të bëhet ankim në Gjykatën e Lartë brenda 3 ditëve nga shpallja e tyre.

Gjykata e Lartë shqyrton ankimin dhe brenda 3 ditëve jep vendimin e formës së prerë, të cilin e shpall menjëherë.

Vendimet e Gjykatës së Lartë që jepen mbi ankime për rezultatet e zgjedhjeve, i bëhen të njohura Komisionit të Mandateve të Kuvendit të ri Popullor.

KREU VIII FUSHATA E ZGJEDHJEVE

Neni 51

Fushata e zgjedhjeve fillon me shpalljen e datës së zgjedhjeve dhe mbyllet 24 orë para kësaj date.

Neni 52

Gjatë fushatës së zgjedhjeve, çdo subjekt elektoral, si dhe shtetasit kanë të drejtë të bëjnë propagandë lirisht nëpërmjet mitingjeve, mbledhjeve, radios, televizionit, shtypit dhe mjeteve të tjera të informacionit masiv.

Ndalohet çdo lloj propagande që zhvillohet në kundërshtim me ligjet, rendin juridik ose që prek dinjitetin personal të kandidatëve.

Publikimi i anketave lidhur me zgjedhjet ndërpritet 8 ditë para datës së zgjedhjeve.

Neni 53

Fushata elektorale në Radiotelevizion bëhet në emisione të posaçme për të. Në këto emisione hapësira për subjekte të ndryshme elektorale përcaktohet në përpjestim me numrin e kandidatëve të paraqitur në shkallë vendi.

Një ditë përpara mbylljes së fushatës së zgjedhjeve u lejohej të gjithë subjekteve të bëjnë një përmbledhje të shkurtër të programit të tyre dhe thirrje drejtuar elektoratit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizon në Radiotelevizionin Shqiptar emisione për edukimin elektoral të popullsisë, duke përfshirë qendrime partiake.

Neni 54

Kandidatët, si dhe subjektet elektorale kanë të drejtë të përdorin materiale të ndryshme propagandistike si parrulla, lajmërimi, fletushka etj., në të cilat duhet të shënohet emri i subjektit elektoral që i përkatet këto materiale. Ndalohet dëmtimi i tyre deri në fund të fushatës.

Organet e pushtetit lokal duhet të sigurojnë mundësi të barabarta propagandimi për çdo subjekt elektoral.

Neni 55

Ndalohet zhvillimi i fushatës së zgjedhjeve në njësitë dhe repartet ushtarake, si dhe në institucionet e depolitizuara.

Komandat e njësisë e të reparteve ushtarake të lejojnë përdorimin e mjeteve të informimit masiv në kohën e lirë, si dhe pjesëmarrjen në fushatën elektorale, brenda territorit të zonës së zgjedhjeve, jashtë njësisë apo repartit.

Neni 56

Ndalohet zhvillimi i fushatës elektorale nga persona që nuk kanë shtetësinë shqiptare.

Neni 57

Komitetet ekzekutive pluraliste të përkohshme, si dhe çdo organ tjetër shtetëror nuk kanë të drejtë të shpërndajnë materiale propagandistike elektorale dhe të marrin pjesë në propagandën që zhvillohet.

Neni 58

Shteti kontribuon për fushatën elektorale të subjekteve si vijon:

a) 50 për qind e shumës së caktuar shpërndahet ndërmjet subjekteve elektorale në përpjestim me kandidatët e regjistruar për deputetë.

b) 50 për qind e shumës së caktuar u ndahet partive në përpjestim me numrin e votave në shkallë kombëtare të fituara në zgjedhjet e mëparshme.

Në rast se subjekti elektoral nuk fiton mbi 3 për qind të votave të të gjitha zonave elektorale ku ka konkuruar, detyrohet t'i kthejë shtetit shumën e financuar.

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë rregullat e financimit, të përdorimit dhe të kontrollit të fondeve të akorduara.

Neni 59

Ndalohet shpifja dhe fyerja kundër kandidatit për deputet dhe subjektit elektoral.

Gazeta a çdo mjet tjetër i informacionit masiv që ka publikuar një material, nëpërmjet të cilit është shkelur një nga të drejtat e kandidatit për deputet në Kuvendin Popullor ose që me çfarëdo mënyre ka cënuar dinjitetin e tij, janë të detyruara të publikojnë gratis replikën në numrin ose në

emisionin menjëherë vijues, në të njëjtin vend dhe në hapësirë e gjatësi deri të barabartë me materialin që është bërë shkak për replikën.

Neni 60

Ndalohet prishja dhe çrregullimi i mbledhjeve dhe mitingjeve elektorale të ligjshme.

Neni 61

Kandidatëve për deputetë në Kuvendin Popullor, gjatë fushatës së zgjedhjeve, kur shkëputen nga puna, u ruhet vendi i punës dhe u jepet pagë e plotë.

Nuk iu ruhet vendi i punës personave që caktohen në nenin 19, shkronja "a" dhe "b" të paragrafit të parë, të këtij ligji.

Neni 62

Kandidatët për deputetë nuk mund të merren në përgjegjësi penale, të arrestohen apo të ndalohen, përveç rasteve kur kryejnë një krim të dukshëm e të rëndë.

KREU IX VOTIMI

Neni 63

Votimi për deputetët e Kuvendit Popullor bëhet në mjedise të caktuara nga komitetet ekzekutive pluraliste të përkohshme të rretheve, të rajoneve, të qyteteve, të lagjeve të qyteteve dhe të fshatrave. Në to nuk lejohet të ketë asnjë material propagandistik.

Ndalohet përdorimi si qendra votimi i godinave të partive politike dhe i institucioneve shtetërore të depolitizuara.

Neni 64

Votimi për deputetët e Kuvendit Popullor bëhet në një ditë pushimi për të gjithë vendin.

Votimi fillon në orën 07⁰⁰ dhe mbyllet në orën 18⁰⁰. Në qoftë se pas orës 18⁰⁰ ka ende njerëz që presin të votojnë, votimi vazhdon derisa të mbarojnë të gjithë të pranishmit.

Kryetari i komisionit të qendrës së votimit në orën 07⁰⁰ të ditës së votimit, në prani të më shumë se gjysmës së anëtarëve, deklaron fillimin e votimit.

Votimi fillon me kontrollin e kutive të votimit në praninë e komisionit dhe të vëzhguesve. Pas kësaj kutitë mbyllet dhe vulosen me vulën e qendrës së votimit, e cila mbahet në ruajtje.

Kryetari i komisionit të qendrës së votimit, në prani të komisionit, vulos në anën e majtë sipër të gjitha fletët e votimit, numri i të cilave shënohet në procesverbalin që firmoset nga i gjithë komisioni i pranishëm.

Pas vulosjes, kryetari dhe dy përfaqësues të partive të ndryshme, në prani të anëtarëve të komisionit, firmosin në anën e djathtë të fletëve të votimit.

Neni 65

Zgjedhësit votojnë sipas radhës së paraqitjes.

Çdo votues është i detyruar të vërtetojë identitetin e tij, duke paraqitur letërnjoftimin, librezën ushtarake për ushtarakët, në çdo rast me fotografi të rregullt ose pasaportën ndërkombëtare për ata që kanë ardhur nga jashtë shtetit.

Ushtarakët nuk lejohet të paraqiten në qendrën e votimit si trup i rreshtuar dhe me armë. Lejohen të paraqiten me uniformë vetëm ushtarakët që janë në shërbim.

Mbas verifikimit të të dhënave të dokumentit identifikues me listën e zgjedhësve, zgjedhësi firmos në listën elektorale. Pas shënimit të numrit të dokumentit identifikues, zgjedhësi merr fletën e

votimit dhe voton. Pas votimit, në faqen e fundit të dokumentit të identifikimit vihet vula.

Kur konstatohet që fleta e votimit nuk është e rregullt, ajo veçohet, shënohet dhe firmoset si e pavlefshme dhe zëvendësohet me një tjetër nga kryetari.

Neni 66

Dhoma e votimit mund të ketë disa ndarje të veçanta për të shpejtuar procesin e votimit. Në ndarjet e veçanta të dhomës së votimit ndalohet të ketë fletë votimi.

Tryeza e komisionit vendoset në mënyrë të tillë që rreth saj të lëvizin anëtarët e komisionit dhe vëzhguesit që përfaqësojnë subjektet elektorale. Kutitë e votimit vendosen në një vend të dukshëm për të gjithë të pranishmit.

Në ndarjet e caktuara për votim ndalohet prania e ndonjë personi tjetër apo dhe anëtari të komisionit të qendrës së votimit, me përjashtim të rasteve kur votuesi nuk mund të kryejë vetë procedurën e domosdoshme të votimit dhe kërkon ndihmë nga një person i zgjedhur prej tij. Personi i zgjedhur ka të drejtë të shoqërojë vetëm një votues. Në këto raste, merret leje nga kryetari i komisionit të qendrës së votimit dhe kjo shënohet në listën e zgjedhësve.

Nuk lejohet votimi haptas ose jashtë ndarjeve të veçanta të dhomës së votimit. Në këtë rast, vota quhet e pavlefshme dhe fletëvotimi grisët nga komisioni pa u hedhur në kutinë e votimit, duke i dhënë zgjedhësit edhe një herë tjetër mundësinë për të votuar.

Kur ka zgjedhës në ndarjet e dhomës së votimit ndalohet çdo person të jetë më afër se 3 metra nga ndarja.

Në qoftë se është e nevojshme për të vendosur rregull në qendrën e votimit, kryetari i komisionit të qendrës së votimit, mund të kërkojë ndihmën e organeve të policisë.

Në qendrën e votimit ndalohet të futen persona të armatosur.

Subjektet elektorale kanë të drejtë të dërgojnë nga një vëzhgues të tyre në çdo qendër votimi, i cili pajiset me autorizimi të komisionit të zgjedhjeve të zonës.

Neni 67

Votimi kryhet sipas fletëvotimit formular, modeli i së cilës i bashkëlidhet këtij ligji. Fletëvotimet janë të njëjta në formë, madhësi, ngjyrë e përbërje të letrës.

Fletëvotimi është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e majtë shënohen emrat e kandidatëve sipas rendit alfabetik. Në pjesën e djathtë shënohen emërtimet e subjekteve elektorale përkatëse që parprijen nga simbolet apo siglat e tyre dhe për kandidatët e pavarur shkruhen fjalët "kandidat i pavarur".

Neni 68

Fletëvotimi është i vlefshëm si për kandidatin, ashtu edhe për subjektin, kur zgjedhësi lë vetëm emrin e kandidatit dhe të subjektit, pro të cilëve voton, duke fshirë me vizë të gjithë emrat e kandidatëve dhe të subjekteve të tjerë.

Fletëvotimi është i vlefshëm si për kandidatin ashtu edhe për subjektin, edhe kur zgjedhësi lë vetëm emrin e kandidatit pro të cilit voton, duke fshirë me vizë të gjithë emrat e kandidatëve të tjerë, pavarësisht nëse fshin apo lë emrat e subjekteve.

Neni 69

Të gjitha fletëvotimet e plotësuara gabim, të grisura, të dëmtuara ose të përdorura ruhen për inventarin kontrollues përfundimtar.

Neni 70

Kur ka shkelje të rënda të procesit të votimit, komisioni i qendrës së votimit mund të vendosë pezullimin e votimit, derisa shkeljet të eliminohen. Ky vendim i bëhet i ditur menjëherë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 71

Fletëvotimi me emrat e kandidatëve për deputetë të zonës dhe listat e kandidatëve për deputetë në shkallë vendi të subjekteve të tyre elektorale, afishohen jashtë dhomës së votimit ose në çdo vend tjetër të dukshëm për t'u lexuar.

KREU X REZULTATET E VOTIMIT

Neni 72

Menjëherë pasi përfundon votimi, kryetari i qendrës së votimit në prani të komisionit dhe të vëzhguesve të autorizuar:

a) Deklaron votimin të përfunduar;

b) Numëron zgjedhësit që kanë marrë pjesë në votim sipas listave, të cilat duhet të firmosen nga kryetari e sekretari i komisionit dhe nga çdo përfaqësues subjekti elektoral që dëshiron.

Listat vendosen në një zarf që vulolet me të njëjtën vulë të qendrës së votimit. Mbi zarf firmosin kryetari dhe sekretari i komisionit dhe përfaqësuesit e subjekteve që dëshirojnë. Zarfi dërgohet në komisionin e zgjedhjeve të zonës prej nga merret vërtetimi përkatës.

c) Numëron fletëvotimet e papërdorura, me të cilat veprohet sipas mënyrës së treguar në paragrafin e dytë të shkronjës "b".

Këto veprime duhet të kryhen sipas rradhës së mësipërme, duke u shënuar kjo në procesverbalin përfundimtar.

Neni 73

Pas kryerjes së veprimeve të mësipërme:

a) Hapen kutitë e votimit dhe njëri nga anëtarët e komisionit i caktuar me short, nxjerr një fletëvotimi dhe ia jep kryetarit, i cili me zë të lartë deklaron nëse fleta është e vlefshme dhe cilit kandidat e cilit subjekt i takojnë votat. Këtë fletë ua jep ta shohin të gjithë anëtarëve të komisionit, dhe vëzhguesve të pranishëm. Vetëm mbasi regjistrohen rezultatet fleta vihet në vendin e caktuar mund të nxirrt një fletë tjetër votimi.

b) Bëhet numërimi i fletëvotimeve të përdorura, të vlefshme dhe të pavlefshme.

c) Verifikohet përmbajtja e shifrave të procesverbalit, duke përsëritur numërimin kur nevojitet.

Këto veprime bëhen sipas rradhës së mësipërme, duke u shënuar kjo në procesverbal.

Neni 74

Fletëvotimet janë të pavlefshme kur:

a) Kur nuk del e qartë krejtësisht se për cilin kandidat është dhënë vota.

b) Kur nuk janë sipas kërkesave të formëse, madhësisë, ngjyrës, përbërjes së letrës, përmbajtjes, vulosjes, nënshkrimit e përkatësisë së zonës elektorale.

c) Kur në fletëvotimin janë lënë pa u fshirë më shumë se një kandidat ose janë fshirë të gjithë kandidatët.

ç) Kur në fletëvotimin shtohen emra të tjerë.

d) Kur fletëvotimi është prishur aq shumë, saqë nuk kuptohet çfarë shprehet në të.

dh) Kur në fletëvotimi janë vënë shkrime ose shenja që bëjnë të mundur të kuptohet identiteti i zgjedhësit.

Vlerësimi i votës bëhet nga komisioni i qendrës së votimit.

Votat e diskutueshme fillimisht shqyrtohen dhe pastaj vlerësohen.

Çdo kundërshtim nga anëtarët e komisionit shënohet në procesverbal dhe këto fletëvotimi ruhen veçmas.

Neni 75

Në përfundim të votimit, vlerësimit dhe numërimit të votave hartohet procesverbali përkatës.

Në procesverbal përcaktohen:

- a) Numri i qendrës së votimit dhe i zonës elektorale.
- b) Koha e fillimit dhe e përfundimit të votimit.
- c) Numri i zgjedhësve në listën e zgjedhësve.
- d) Numri i zgjedhësve në listën shtesë.
- e) Numri i votuesve sipas shënimeve të listës së zgjedhësve.
- ë) Numri i fletëvotimeve të vlefshme.
- f) Numri i votave për çdo kandidat e subjekt elektorale.
- g) Numri i fletëvotimeve të pavlefshme.
- h) Numri i fletëvotimeve të nxjerra jashtë përdorimit përpara votimit.
- i) Numri i fletëvotimeve të papërdorura.
- j) Vërejtjet e ndryshme të motivuara të anëtarëve e vëzhguesve të veçantë.
- k) Numri i kopjeve në të cilat është hartuar pprocesverbali.

Të dhënat e pikave nga "c" deri në "i" jepen me shifra dhe fjalë.

Procesverbali firmoset në çdo fletë. Çdo korrigjim eventuale firmoset duke shënuar fjalën "korrigjim".

Çdo subjekt elektorale ka të drejtë të marrë një kopje të procesverbalit.

Neni 76

Komisioni i qendrës së votimit duhet:

1. Të dërgojë dy kopje të procesverbalit me rezultatet e votimit në komisionin e zgjedhjeve të zonës, nga të cilat njëra është për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

2. Një kopje të procesverbalit, së bashku me fletëvotimet dhe zarfet ia dërgon komitetit ekzekutiv pluralist të përkohshëm të rrethit.

Të gjitha këto materiale dorëzohen personalisht nga kryetari dhe sekretari i komisionit të qendrës së votimit së bashku me cilindro nga përfaqësuesit e subjekteve elektorale.

Neni 77

Komisioni i zgjedhjeve të zonës mnxjerr rezultatet e votimeve në bazën e të dhënave të procesverbaleve të qendrave të votimit dhe i shpall ato në formën e një procesverbali, i cili duhet të përmbajë:

1. Numrin e qendrave të votimit.
2. Qendrat e votimit që kanë paraqitur procesverbale.
3. Numrin e zgjedhësve sipas listave të zgjedhësve.
4. Numrin e votuesve sipas shënimeve në lista.
5. Numrin e votuesve sipas fletëve të hedhura në kuti.
6. Numrin e votave të vlefshme përkatësisht për çdo kandidat dhe subjekt.
7. Votat e pavlefshme.
8. Emrin, atësinë dhe mbiemrin e kandidatit që fiton.
9. Ankimet, vërejtjet dhe vendimet për to.

Të dhënat në numrat nga 1 deri në 7 duhet të bëhen me shifra dhe fjalë.

Neni 78

Komisioni i zgjedhjeve të zonës duhet të dërgojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve një kopje të çdo procesverbali të mbajtur nga ana e tij, si dhe procesverbalet që i janë dërguar nga komisionet e qendrave të votimit.

Komisioni i zgjedhjeve të zonës dërgon në komitetin ekzekutiv pluralist të përkohshëm të rrethit zarfet, fletëvotimet dhe çdo material tjetër të ardhur nga qendrat e votimit.

Dorëzimi i materialeve të mësipërme bëhet nga kryetari, sekretari i komisionit të zgjedhjeve

dhe nga çdo përfaqësues subjekti elektoral që dëshiron.

Neni 79

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall dhe boton rezultatet e zgjedhjeve në Fletoren Zyrtare, si dhe një buletin të posaçëm menjëherë pas nxjerrjes së tyre.

Mbas përfundimit të zgjedhjeve dhe zgjidhjes së konflikteve të mundshme, të gjitha materialet dërgohen në aktivin e Kuvendit Popullor.

KREU XI

MARRJA FUND E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT POPULLOR

Neni 80

Mandati i deputetit të Kuvendit Popullor merr fund para afatit në këto raste:

- a) Kur deputeti jep dorëheqjen.
- b) Kur deputeti deklarohet fajtor me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi.
- c) Kur deputeti refuzon të bëjë betimin e parashikuar në rregulloren e Kuvendit Popullor.
- ç) Kur deputeti vdes.

Neni 81

Në rastet e mbarimit para afatit të mandatit të deputetit, Komisioni i Mandateve të Kuvendit Popullor shpall të zgjedhur kandidatin e rradhës në listën në shkallë vendi. Në rastin kur deputeti, të cilit i mbaron mandati, nuk përfaqëson një subjekt që ka lista në shkallë vendi, në zonën e tij kryhen zgjedhje brenda 3 muajve.

Kur një deputet merr përsipër një detyrë tjetër që nuk pajtohet me mandatin e tij, ai zëvendësohet nga kandidati I rradhës në listën përkatëse në shkallë vendi.

Në qoftë se një deputet caktohet ministër, ai mund të zëvendësohet vetëm për kohën që qëndron në detyrën e ministrit, nga kandidati i rradhës në listën përkatëse në shkallë vendi.

KREU XII

DISPOZITA PENALE DHE ADMINISTRATIVE

Neni 82

Kushdo që për interes të tij ose të personave të tretë, ofron të holla, vende pune ose favore të tjera në cilëndo formë, për marrjen e firmës për paraqitjen e kandidatit, për votim pro ose kundra apo për mospjesëmarrje në votim, dënohet me heqje të lirisë nga 6 muaj deri në 3 vjet.

Këto dënime jepen edhe ndaj zgjedhësit që për kryerjen e veprimeve të mësipërme merr të holla ose përfiton vende pune a favore të tjera në çdo lloj forme.

Në të njëjtën mënyrë dënohen edhe ata që kërcënojnë apo shtrëngojnë zgjedhësin për kryerjen e veprimeve të mësipërme.

Neni 83

Kushdo që për interes të tij ose të personave të tretë, për të ndikuar në zgjedhje shpërndan në çdo lloj forme gjatë fushatës elektorale dhe ditën e votimeve, të holla, sende konsumi ose dhurata të tjera, dënohet me heqje të lirisë nga 1 deri në 3 vjet.

Neni 84

Shkelja e rregullave të tjera të parashikuara në këtë ligj dënohet me gjobë nga 100 deri në 500 lekë, me përjashtim të rasteve kur shkelja e kryer përbën vepër penale.

Neni 85

Për shkeljen e dispozitave që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe administrimin e rregullt të fletëvotimeve, listave të zgjedhësve, të kutive dhe të procesverbaleve të votimit, masa e gjobës rritet nga 500 deri në 1 000 lekë, me përjashtim të rasteve kur shkelja përbën veper penale.

Neni 86

Personat e ngarkuar me detyra në bazë të këtij ligji, kur nuk zbatojnë rregullat e parashikuara në nenet 84 dhe 85 të tij, dënohen me gjobë nga 1000 deri në 1500 lekë, me përjashtim të rasteve kur shkelja përbën vepër penale.

Neni 87

Vendimet e dënimit me gjobë për shkelje administrative, jepen nga komisionet e zgjedhjeve të zonave ose nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Vendimet e dënimit me gjobë, që kanë marrë formën e prerë formojnë tituj ekzekutivë.

KREU XIII DISPOZITA TRANZITORE DHE TË FUNDIT

Neni 88

Për zbatimin e këtij ligji Komisioni Qendror i Zgjedhjeve lëshon udhëzime të veçanta.

Neni 89

Vëzhgues në kuptim të këtij ligji konsiderohen:

- Përfaqësuesit parlamentarë të shteteve anëtare të KSBE, të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, të Parlamentit Evropian dhe të organizatave të tjera që lildhen me çështjen e të drejtave të njeriut.

- Përfaqësuesit e partive dhe të lëvizjeve politike të huaja, si dhe individë të ftuar nga partitë dhe grupime partish.

- Përfaqësues të autorizuar nga organizata të vendit e të huaj, të specializuar në fushën e zgjedhjeve.

Neni 90

Vëzhguesit e zgjedhjeve, gazetarët dhe përfaqësuesit e mjeteve të informimit të akredituar në vendin tonë, të pajisen me autorizim të posaçëm nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Vëzhguesit e zgjedhjeve kanë të drejtë të lëvizin lirisht në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të vëzhgojnë të gjithë veprimtaritë që bëhen, si gjatë fushatës elektorale, ashtu edhe ditën e votimit. Ata kanë të drejtë të pyesin, të mbledhin të dhëna dhe të japin publikisht mendime, duke qenë të paanshëm.

Neni 91

Shtetasit shqiptarë që jetojnë në mënyrë të përhershme jashtë shtetit ose që kanë jetuar atje më tepër se 1 vit dhe kur ndodhen në Shqipëri e kërkojnë të marrin pjesë në votime, e provojnë identitetin e tyre me pasportën ndërkombëtare që mbajnë. Ata duhet të plotësojnë një deklaratë, ku të pohojnë se nuk mbajnë letërnjoftimi të vlefshëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 92

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për sigurimin e bazës materiale e financiare për marrjen e masave organizative për zbatimin e këtij ligji.

Neni 93

Ligji nr.7423, datë 13.11.1990 "Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligji, shfuqizohen.

Neni 94

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.126, datë 6.2.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia.

Shtojca 1

MODALITETI E NJEHSIMIT TË VENDEVE TË FITUARA NGA SUBJEKTET ELEKTORALE ME MANDATET SHITESË KOMPENSUES SIPAS PROPORCIONIT

I. Paraqitja e rezultateve

Subjekti	Numri i vendeve të fituar në listën njëemërore	Përqindja e fituar në shkallë vendi	Përqindja e ndrequr
1	a_1	b_1	$A_1 = b_1/(1-y\%)$
2	a_2	b_2	$A_2 = b_2/(1-y\%)$
3	a_3	b_3	$A_3 = b_3/(1-y\%)$
n	a_n	b_n	$A_n = b_n/(1-y\%)$
Subjekti me nën 4% të votave	x	y	

II. Njehsimi i numrit të deputetëve të Kuvendit Popullor (N_{KP})

$$N_i = \frac{a_i \cdot 100}{A_i} \quad i = 1, 2, \dots, n$$

$$N_{max} = \max (N_1, N_2 \dots N_n) \quad \text{a) Në rast se } N_{max} < 140 \text{ atëherë } N_{KP} = 140$$

$$\text{b) Në rast se } N_{max} \geq 140 \text{ atëherë } N_{KP} = N_{max}$$

III. Njehsimi i vendeve të fituara nga çdo subjekt (P)

$$P_i = A_i \% (N_{KP} - X)$$

Fillimisht caktohet për çdo parti politike sa deputetë i takojnë nga pjesa e plotë e P_i -së. Mblidhet sasia e vendeve të caktuara më sipër për të gjitha partitë dhe i zbritet numrit të deputetëve në Kuvendin Popullor N_{KP} . Kjo diferencë i ndahet me nga një vend atyre partive që kanë pjesën më të madhe dhjetore të P_i -së.

IV. Njehsimi i vendeve shtesë ndaj listës njëemërore të fituara nga çdo subjekt (Sh_i)

$$Sh_i = P_i - a_i$$

ZONAT E ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN POPULLOR SIPAS RRETHEVE

1. Berati	5	15. Lushnja	4
2. Dibra	4	16. Mati	2
3. Durrësi	5	17. Mirdita	2
4. Elbasani	7	18. Përmeti	1
5. Fieri	8	19. Pogradeci	2
6. Gramshi	1	20. Puka	2
7. Gjirokastra	2	21. Saranda	3
8. Kavaja	3	22. Skrapari	2
9. Kolonja	1	23. Shkodra	8
10. Korça	7	24. Tepelena	2
11. Kruja	3	25. Tirana	12
12. Kukësi	3	26. Tropoja	1
13. Lezha	2	27. Vlora	6
14. Librazhdi	2		

(Për raundin e parë)

FLETÈ VOTIMI

PËR ZGJEDHJET E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(Vula e komisionit)

Zona nr.

Data e zgjedhjeve

Kryetari

~~Pă-~~ komisionin e votimit